



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, neni 5 pika c, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës neni 35, Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës, neni 8 si dhe Udhëzimit Administrativ, 09/2014, Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpallë :

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

-I- Shkollat Filllore :

1. **Shkolla Filllore “Thimi Mitko” në Gjiçan**
 - Një mësimdhënëse të lëndës së edukatës fizike
2. **Shkolla Filllore” Lagjja e II” në Gjiçan**
 - Një mësimdhënëse të lëndës teknologji informative
3. **Shkolla Filllore “ Agim Ramadani” Zhegër**
 - Një mësimdhënëse të ciklit klasor
4. **Shkolla Filllore “ Lagjja e VIII” në Gjiçan**
 - Një mësimdhënëse të ciklit klasor
5. **Shkolla Filllore ‘ Nazim Hikmet’ në Dobërçan**
 - Një mësimdhënëse të ciklit klasor
6. **Shkolla e Mesme Teknike “Mehmet Isai”**
 - Një mësimdhënëse të lëndës së gjuhës angleze, 18 orë
7. **Shkolla e Mesme e Bujqësisë “Arbëria”**
 - Një mësimdhënëse të gjuhës angleze
 - Një mësimdhënëse të lëndës së tekstilit, 19 orë
8. **Shkolla e Muzikës**
 - Një mësimdhënëse të lëndës Teknologji e Muzikës dhe Piano -shkolla e mesme
 - Tre mësimdhënëse – Piano - shkolla e mesme dhe filllore

Kohëzgjatja e kontratës për këto vende të punës është :

Pika 1, prej 01.09.2014 deri 31.12.2014

Pika 3, në kohë të caktuar

Pika 4, në kohë të caktuar

Pika 8, shkolla e muzikës : pushim i lehonisë dhe njëri prej 01.10.2014 deri 31.03.2015.

Kushtet e konkursit :

Kualifikimi për mësimdhënëse : kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit të MASHT-it, Nr. 09/2014, në mungesë të kandidatëve të cilët kërkohen sipas normativit në fjalë, komisioni do të bëjë një emërim të përkohshëm, konform nenit 35 paragraf 5 të ligjit për arsimin parauniversitar, nr.04/L-032, nga radha e kandidatëve me kualifikim dhe kushte më të përafërt. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it, nr. 8/2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Për vendet e punës në fjalë nevojiten këto dokumente: Diploma mbi përgatitjen profesionale ,kopja e letërnjoftimit, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori

gjendjes civile me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, si dhe vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit .

Për këto vende të punës, kandidatët do t'i nënshtrohen intervistës me gojë.

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioeve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe në pajtim me normativin, 09/2014.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Për vendin dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen përmes listës-ftuese e cila do të vendoset në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë, pas mbylljes së konkursit.

Drejtori
Nazmi Musa